**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAMËZ**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

**Nr.**51 **prot.** **Kamëz, më** 19.04**.2021**

**V E N D I M**

**Nr.**42**.Datë**19 / 04**2021**

**PËR**
**NJOHJEN E KONTRATËS NR.79 PROT., DATË 06.01.2021 PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR/KULLOSOR KOMBËTAR LIDHUR MIDIS SUBJEKTIT GEMINI SH.P.K DHE BASHKISE KRUJË**

**Këshilli Bashkiak Kamëz** i mbledhur sot më **19.04.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Nr.36 Datë 12.04.2021** në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b"; nënpika 1.2. shkronja "a";nenit 54, të ligjit 139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore", I ndryshuar; nenit 19 tëligjit nr. 9385,date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", ndryshuar,ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", I ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 29.05.2019 "Pë rmiratimin e hartës së për ditësuar të kufijve administrative territorial të njësive të vetëqeverisjes vendore",Vendim nr.13, datë 19.02.2021 I Këshillit Bashkiak Kamëz "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrative territorial dhe fshatrave Brenda territorit të Bashkisë Kamëz", **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

**V E N D O S I :**

1. Dhënien e pëlqimit përnjohjen e Kontratës nr.79 prot., datë 06.01.2021 lidhur mes subjektit Gemini sh.p.k dhe Bashkisë Krujë
2. Efektet financiare si dhe çdo efekt tjetër që prodhon kontrata e sipërcituar të jenë përllogari të Bashkisë Kamëz.
3. Ngarkohet nga Zyra Juridike për zbatimin e këtij vendimi dhe lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin ''Gemini'' sh.p.k sipas kushteve të përcaktuara në kontratën nr.79 prot., datë 06.01.2021
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Nën/ Kryetar Këshilli**
**Ali Dauti**

Adresa: Bulevardi Blu, Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al